

Takim me ambasadorët e vendeve pjesëmarrëse në SEECP

Drejtoria e Rajonit dhe Vendeve Fqinje zhvilloi sot një takim me ambasadorët në Tiranë të vendeve pjesëmarrëse të Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECP).



Takimi kishte për qëllim informimin e kolegëve me dokumentet e Kryesisë Shqiptare të SEECP-së, Prioritetet dhe Kalendari i Aktiviteteve, si dhe u diskutua rreth qëllimeve që Shqipëria kërkon të përmbush nëpërmjet kësaj Kryesie dhe mbi aktivitetet e shumta që priten të zhvillohen.

Takimi i shërbeu nxitjes dhe lehtësimit të bashkëpunimit si dhe rritjes së komunikimit për realizimin e aktiviteteve të parashikuara.